



## P R O C E S V E R B A L

Mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) - Rahovec, e mbajtur më **19.6.2024**, me fillim në orën **15:10**. Mbledhjen e kryesoi Kryetari i Komunës, **Smajl Latifi**. Për mbajtjen e mbledhjes kuorumi ekziston. Në fillim të mbledhjes, të pranishëm ishin 20 anëtarë.

**Kryetari:** Më lejoni t'i përshëndes anëtarët e KKSBB-së, drejtorët e drejtorive, komandantin e stacionit të policisë në Rahovec, z. Fazli Morina, përfaqësuesit e bashkësive fetare, përfaqësuesit e FSK-së, të shoqërisë civile, të bizneseve, të komuniteteve pakicë, të OSBE-së, të KFOR-it, të UEN-it, të LMT-së, zyrtarët komunalë dhe mediet. Është mbledhja e katërt e rregullt për vitin 2024. Për këtë mbledhje, propozoj këtë:

- 1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit;**
  - Siguria në trafik;
  - Plani operativ për sezonin e pushimeve të mërgimtarëve dhe të dasmave;
- 3. Çështja e ujit të pajes në komunën e Rahovecit;**
- 4. Diskutim për aktivitetet e organizuara nga Drejtoria për Arsim për maturantët;**
- 5. Mbrojtja e lumenjve që rrjedhin në territorin e Komunës së Rahovecit, deponitë dhe mbeturinat;**
- 6. Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore;**
- 7. Të ndryshme.**

**Kryetari:** Mirëdita, të nderuar pjesëmarrës! Është mbledhja e katërt e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi. Përshëndetje për përfaqësues të KFOR-it, të OSBE-së, përshëndetje për të gjithë! Kësaj radhe, zyrtarisht i kemi të ftuar edhe menaxhmentin e K.R.U. "Gjakova", sepse si pikë të tretë e kemi edhe çështjen e ujit të pajes në Komunën e Rahovecit. E përshëndes kryeshefin ekzekutiv, Hasan Krasniqi, drejtorin teknik, Visar Hasi dhe përgjegjësin për Rahovec, z. Hysni Çanta. Faleminderit për ardhjen tuaj! Rendin e ditës e keni para vetes. A ka dikush ndonjë koment rreth këtij propozimi shtesë për rend dite? Nëse jo, po e vendosim në votim, kush është "për" miratimin e pikave të cilat i paraqita? A ka votë kundër?... Abstenime?... Konstatojmë që njëzëri miratohet rendi i ditës për këtë mbledhje.

**1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:**

**Kryetari:** A ka dikush ndonjë vërejtje, koment ose plotësim rreth procesverbalit?

Nëse nuk ka, atëherë po e vendosim në votim. Kush është "për"?... A ka votë kundër?.. Abstenime?... Aprovohet pika e parë, kalojmë në të dytën.

**2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit:**

**Kryetari:** Sa i përket pikës së dytë të rendit të ditës, situata e sigurisë në Komunën e Rahovecit është e qetë dhe stabile, gjithnjë duke u bazuar në informatat e përditshme që më vijnë në zyrë nga stacioni policor në Rahovec. Për më shumë rreth kësaj pike, fjalën ia jap komandantit të policisë.

**Fazli Morina:** Faleminderit, kryetar! Sot, pasi është edhe loja e Evropianit 2024, në mes të Shqipërisë dhe të Kroacisë, nuk do ta zgjas shumë, por raportin do ta lexoj në pika të shkurtra. Gjendja e sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit është e qetë dhe stabile, pa ndonjë ndryshim të theksuar nga takimi i fundit i KKSBB-së. Gjatë kësaj periudhe, kanë ndodhur 45 vepra penale, 1 rast incident jopenal. Dhunë në familje: 8 raste, 3 vjedhje dhe armëmbajtje pa leje: 1 rast. Janë arrestuar 7 persona. Sa i përket sigurisë në komunikacion rrugor: Janë dhënë 671 gjoba në komunikacion rrugor. Prej tyre, 25 gjoba janë shqiptuar për drejtimin e automjetit pa patent-shofer, 9 gjoba për mbajtje të telefonit gjatë vozitjes, 108 gjoba për parkingje joadekuate, 5 gjoba për prishje të rendit dhe të qetësisë publike. Nga shkollat e komunës së Rahovecit, janë realizuar 17 pika të kontrollit afër shkollave.

**Kryetari:** Faleminderit, komandant! **Atëherë, si konkluzë e kemi gjendjen e qetë, stabile dhe pa ndonjë ndryshim të theksuar prej takimit të fundit të mbledhjes së KKSBB-së.**

### **3. Çështja ujtit të pajes në Komunën e Rahovecit:**

**Kryetari:** Së pari e falënderoj menaxhmentin e K.R.U. "Gjakova", për pjesëmarrjen e tyre në këtë takim! Ne, me K.R.U. "Gjakova" kemi bashkëpunim. Komuna e Rahovecit është aksionare në K.R.U. "Gjakova". Në të gjitha projektet që i kemi bashkë me K.R.U. "Gjakova", Komuna e Rahovecit participon me 49%, ndërsa ata me 51%. Janë bërë shumë projekte të përbashkëta, ku kemi dalë të kënaqur, por kohëve të fundit kemi kritika sa i përket menaxhimit të K.R.U. "Gjakova", si me furnizimin e ujit të pajes për Komunën e Rahovecit, ashtu edhe për investimet e përbashkëta kapitale. Vonesat e tyre në punë, kanë bërë që unë mos të jem i kënaqur fare me këtë menaxhment. Shtrimi i gypit të ujtit të pajes në njërin nga projektet që i kemi, në rrugën "Gëzim Hamza", ka tre muaj që është duke u zvarritur nga K.R.U. "Gjakova". Ne si komunë jemi në pritje të përfundimit të shtrimit të gypit sipas standardeve, në mënyrë që të bëhet edhe asfaltimi i asaj rruge. Nuk më pëlqen kjo gjendje e krijuar nga ju, sepse qytetarët e Komunës së Rahoveci janë të irrituar nga mosfinalizimi i punëve me kohë. Qytetarët nuk janë në dijeni se punën duhet ta kryejë K.R.U. "Gjakova". Ankesat vijnë drejtësuar tek unë si kryetar i Komunës. Ju lus që punët në këtë rrugë dhe në rrugë tjetra t'i përfundoni sa më shpejt që të jetë e mundur. Shpresoj që këtë vikend të përfundojnë këto punë. Jam gjithashtu i pakënaqur edhe me gropimet që i bëni në rrugët e qytetit dhe nuk i ktheni në gjendjen e mëparshme. Kemi ankesa të shumta nga qytetarët, sepse rrugët në lagjet e tyre janë të pakalueshme nga prerja e asfaltit, heqja e kubëzave dhe moskthimi i tyre në gjendje të mëparshme. Komuna e Rahovecit i ka shqiptuar shumë herë gjoba K.R.U. "Gjakova", për neglizhimin e punëve si në këto raste. Sa i përket ujtit të pajes, kam shumë ankesa nga qytetarët e Rahovecit me rrëthinë, posaçërisht nga Lagjja e Epërme e qytetit. Tani që jemi duke folur, disa fshatra dhe disa pjesë të qytetit nuk kanë ujë të pajes. Këtë mbledhje ju kemi ftuar zyrtarisht që të rrësim bashkëpunimin me ju, duke u bërë më të përgjegjshëm në kryerjen e detyrave.

Kërkoi shpjegim nga menaxhmenti i K.R.U. "Gjakova" rrëth kësaj çështjeje, ankesat vijnë edhe gjatë stinës së dimrit nga shumë vendbanime të Rahovecit. Shpresoj që do të jetë hera e fundit që më vijnë ankesa të tillë nga qytetarët, ku fjala kyçe është mungesa e ujtit të pajes. Kam informacione të sakta që ujë të pajes ka mjaftueshëm në rezervuare dhe gjithashtu nëse ka ndodhur ndonjë sabotim në mes jush si menaxhment, nuk është problemi ynë. Komuna e Rahovecit, bashkë me qytetarët e saj, kërkon llogari kur në ditë të Bajramit ndalet uji, kur në shumicën e rasteve nuk kemi ujë të mjaftueshëm të pajes. Qytetarët e Komunës e paguajnë ujin 100% që i faturohet, kjo i bie që K.R.U. "Gjakova" inkason 100% të mjeteve nga qytetarët e Komunës së Rahovecit.

**Hasan Krasniqi:** Faleminderit për këto fjalë, kryetar! Qeveria e Republikës së Kosovës ka ndarë 1.4 milion € për ujësjellësin e K.R.U. "Gjakova", prej tyre rrëth 900.000€ do të shkojnë për zonën e komunës së Rahovecit. Është e vërtetë ajo që tha kryetari, ka shumë operatorë që nuk janë të përgjegjshëm

në terren, pasi e fitojnë kontratën. Ne jemi bërë edhe medial për një kanal, apo më mirë të themi për thellësinë e tij, në një pjesë të qytetit të Rahovecit. I kemi ndërmarrë veprimet tona dhe menjëherë gjatë ditëve në vijim do t'i përmirësojmë këto gabime nga operatori në fjalë dhe gypi do ta ketë thellësinë sipas standardeve të duhura. Kryetari e përmendi sabotimin, unë nuk do ta quaja ashtu, por ka mundur të jetë një vepër penale e dikujt me tendenca personale, që e ka ndalë ujin për një zonë dhe të njëjtën kohë e ka lëshuar për një zonë tjeter. Kjo është vepër penale dhe duhet ta marrë dënimin e merituar. Ju premtoj që do të ketë përmirësimë në furnizim me ujë të pijes dhe në punën e ndërrimit të gypave në qytet dhe kudo! Lehtësimi i gjendjes së furnizimit të ujit të pijes do të vërehet shumë kur do të përfundojnë punimet në shtrirjen e gypave dhe në zgjerimin e rrjetit në 3 fshatra të komunës: Hoçë e Madhe, Zoqisht dhe Opterushë. Prej ujit që ne e furnizojmë Komunën e Rahovecit, prej 100% furnizim, humbje kemi 60%. Neve na mbetet që inkasimi i mjeteve të jetë vetëm për 40%. Kjo i bie që qytetarët e Komunës së Rahovecit paguajnë 100%, nga 40% e furnizimit që vije nga K.R.U. "Gjakova". Nuk e mohojmë çështjen e keqpërdorimit të ujit, por me kapacitetet tona po mundohemi t'i ndalim keqpërdoruesit. Ka shumë prej qytetarëve në tërë Komunën e Rahovecit që keqpërdorin ujin, posaçërisht gjatë natës, duke e shfrytëzuar për ujitje. Qytetarët e Rahovecit kanë të drejtë të ankohen plotësisht për mungesën e ujit, por ne jemi duke punuar me të gjitha kapacitetet tona që ujë të pijes të ketë gjatë gjithë kohës, për këtë ju premtoj! Po ashtu, apeloj që mos të ketë keqpërdorime, uji të shfrytëzohet me masë të nevojshme.

#### **4. Diskutim për aktivitetet e organizuara nga Drejtoria për Arsim për maturantët:**

**Avni Morina:** Të nderuar anëtarë të KKSB-së, i nderuari kryetar i Komunës! Jemi në fund të vitit mësimor 2023-2024 dhe ju informoj se ne si DKA, gjatë gjithë vitit, kemi qenë në koordinim me shkollat lidhur me mbarëvajtjen e procesit mësimor. Në kohën që po flasim, procesi mësimor i rregullt, i vlefshëm për këtë vit shkollor, ka përfunduar për maturantët dhe klasat e tjera 9,10 dhe 11, mirëpo, viti shkollor ende nuk ka përfunduar. Pas përfundimit të procesit mësimor për maturantët, janë mbajtur edhe riprovimet e vlefshme për afatin e parë, e po ashtu, në 3 shkollat e mesme të larta dhe në IAAP "Selajdin Mullaabazi-Mici", janë organizuar manifestimet e mbrëmjeve të maturës. Për mbarëvajtjen e këtyre organizimeve festive kemi qenë në vazhdimësi në bashkëpunim të ngushtë me Stacionin Policor në Rahovec, pjesëtarët dhe ekipet e të cilit janë kujdesur maksimalisht për sigurinë e nxënësve maturantë para, gjatë dhe pas mbajtjes së mbrëmjeve të maturës nga secila shkollë.

Gjithashtu, ju informoj se ne si DKA kemi bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme që të organizohet dhe të mbahet me sukses provimi shtetëror i maturës, i cili do të mbahet në 3 qendra, më 22 qershori 2024 (ditën e shtunë). Janë emëruar komisionerët dhe menaxherët e qendrave ku do të mbahet Provimi i Maturës dhe urojmë që gjithçka të shkojë mbarë dhe me suksese për maturantët tanë. Pas përfundimit të procesit mësimor, maturantët kanë qenë edhe nëpër ekskursione njëditore nëpër Kosovë, me ç'rast kanë vizituar monumente kulturore dhe historike të vendit tonë, por edhe bukuritë natyrore. Nga raportet që kemi marrë pas ekskursioneve nga drejtorët e shkollave, rezulton se gjithçka ka shkuar mirë dhe mbarë. Ju faleminderit dhe nëse keni ndonjë pyetje për këtë temë, do t'ju përgjigjem!

#### **5. Mbrotja e lumenjve që rrjedhin në territorin e Komunës së Rahovecit, deponitë dhe mbeturinat;**

#### **6. Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore:**

**Kryetari:** Faleminderit! Sa i përket pikës së gjashtë dhe të shtatë, drejtoreshën e Inspektoratit e kemi këtu dhe gjithashtu inspektorët komunalë, por për shkak të agjendës, sot, po i kalojmë këto pika.

#### **7. Të ndryshme:**

**Mustafë Korenica:** Përshëndetje! E kam një pyetje për drejtorin e Shërbimeve Publike, Përparim Krasniqi. Është një kërkesë e cila vjen nga Komuniteti i Bizneseve, që realisht përfaqësohet nga unë, a ka mundësi të na tregosh se në rrugën regionale Xërxe-Rahovec, specifisht nga termosistemi "Osa", në drejtim të Rahovecit, ku do të vendoset rrotullimi i tretë?

**Përparim Krasniqi:** Faleminderit, Mustafë! Do të bëjmë diçka edhe pse nuk lejohet me rregullore. Ne kemi bërë një kërkesë që një rrëthrrötullim të vendoset në afërsi të *Stone Castle* dhe *Hardh Festit*, sepse aty do të jetë edhe kyçja e rrugës për stadiumin e qytetit.

**Konkluzë - Kryetari:** Shpresoj që nga kryeshefi ekzekutiv i K.R.U. "Gjakova" dhe menaxhmenti i tij, do ta mbajnë premtimin e bërë në takimin e sotëm dhe pas këtij takimi, Rahoveci si qytet dhe fshatrat në rrithinë, do të kenë ujë mjaftueshëm, të pijshëm, 24 orë në ditë dhe 7 ditë në javë. Ju falënderoj të gjithëve për kontributin! Shihemi në mbledhjet e radhës!

Procesmbajtësi:

Albion Krasniqi



Kryetari i Komunës

Smajl Latifi

